



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

RAHOVEC /ORAHOVAC



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No. 91274 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 72

Data/Datum/Date 22 / 11 / 2024

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, kërkesës së Ministrisë Ekonomisë me Nr. Prot. 6457, të datës 04.11.2024, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 22.11.2024 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/5028/24 i datës 20.11.2024 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për pjesët e parcelave si në vijim:

1.1.Pjesën e parcelës sipas certifikatës së pronësisë P-71510039-00500-1, në Zonën Kadastrale Kramovik, në sipërfaqe prej 2894m² (dymijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 952267m² (nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë metra katror), në vendin e quajtur boka-boka, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të OP SHARRI-PRISHTINË; EKONOMIA E PYJEVE-RAHOVEC, me të drejtë të shfrytëzimit për kohë të caktuar Ministria e Ekonomisë;

1.2.Pjesën e parcelës sipas certifikatës së pronësisë P-71510061-00184-0, në Zonën Kadastrale Petkoviq, në sipërfaqe prej 568m² (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 90323m² (nëntëdhjetë mijë e treqind e njëzet e tre metra katror) në vendin e quajtur boka-rudina, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të AGJENCIA PYJORE, me të drejtë të shfrytëzimit për kohë të caktuar Ministria e Ekonomisë;

1.3.Pjesën e parcelës sipas certifikatës së pronësisë P-71510061-00199-1, në Zonën Kadastrale Petkoviq, në sipërfaqe prej 2990m² (dymijë e nëntëqind e nëntëdhjetë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 607787m² (gjashtëqind e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë metra katror), në vendin e quajtur rudina-boka, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të AGJENCIA PYJORE, me të drejtë të shfrytëzimit për kohë të caktuar Ministria e Ekonomisë;

1.4.Pjesën e parcelës sipas certifikatës së pronësisë P-71510061-00842-0, në Zonën Kadastrale Petkoviq, në sipërfaqe prej 1868m² (njëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 270723m² (dyqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet e tre metra katror), në vendin e quajtur gudina-gudina, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të AGJENCIA PYJORE, me të drejtë të shfrytëzimit për kohë të caktuar Ministria e Ekonomisë;

1.5.Pjesën e parcelës sipas certifikatës së pronësisë P-71510061-00843-0, në Zonën Kadastrale Petkoviq, në sipërfaqe prej 4225m² (katër mijë e dyqind e njëzet e pesë metra katror) nga

sipërfaqja e përgjithshme prej 568002m² (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dy metra katror) në vendin e quajtur rudina-rudina, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të AGJENCIA PYJORE, me të drejtë të shfrytëzimit për kohë të caktuar Ministria e Ekonomisë;

1.6. Pjesën e parcelës sipas certifikatës së pronësisë P-71510061-00186-0, në Zonën Kadastrale Petkoviq, në sipërfaqe prej 4360m² (katërmijë e treqind e gjashtëdhjetë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 165579m² (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë metra katror), në vendin e quajtur rudina-rudina, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të AGJENCIA PYJORE, me të drejtë të shfrytëzimit për kohë të caktuar Ministria e Ekonomisë.

2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesëve të parcelave të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë “Këmbimi dhe bashkimi i parcelave me Ministrinë e Ekonomisë për ndërtimin e parkut solar 100MW nga “Lindja Solar L.L.C.”.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr.274/24
Datë:22.11.2024

